



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:063996

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05614527

KPPP.nr.2383/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit “TEB” SH.A., me seli në Preoc, Komuna e Graçanicës, kundër debitorëve: 1. “DNT” SH.P.K., me seli në fshatin ..., Malishevë, 2. R.Th., me adresë në fshatin ..., Malishevë, 3. A.Th., me adresë në fshatin ..., Malishevë, 4. A.K., me adresë në fshatin ... Drenas, 5. A.Th.1., me adresë në fshatin ..., Malishevë dhe 6. S.Th., me adresë në fshatin ..., Malishevë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.2837/19 të datës 11.12.2019 të Përbaruesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përbarimit e lejuar sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.2837/19 të datës 11.12.2019 të Përbaruesit Privat Isa Gacaferi, në çështjen përbarimore të kreditorit “TEB” SH.A., kundër debitorëve: 1. “DNT” SH.P.K., 2. R.Th., 3. A.Th., 4. A.K., 5. A.Th.1., dhe 6. S.Th., për shkak të arritjes së marrëveshjes së palëve.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat Isa Gacaferi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “TEB” SH.A., ka caktuar urdhrin P.nr.2837/19 me datën 11.12.2019, kundër debitorëve: 1. “DNT” SH.P.K., 2. R.Th., 3. A.Th., 4. A.K., 5. A.Th.1., dhe 6. S.Th., duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarues Marrëveshjen mbi Kredinë nr. 65341 në shumë prej 240,000.00€ si dhe Shtojcën 1 të datës 27.12.2017 Marrëveshja mbi Pengun, që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 174,393.10€, përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorëve, shitjes së paluajtshmërive të hipotekëlënësit apo sekuestrimit të kolateralit.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit me datën 19.12.2019, debitori TEB SH.A., ka paraqitur prapësim, ndërsa kreditori me datën 20.12.2019 ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Kreditori, me datën 23.04.2024 me anë të Parashtresës me shkrim, e ka njoftuar Gjykatën se debitorët kanë përmbyllur obligimin nga kreditorit dhe nuk kanë më interes juridik për shqyrtimin e më tutjeshëm të kësaj çështje juridike – përmbarimore dhe i ka dorëzuar Urdhërin P.nr. 2837/19 të datës 20.01.2023 të përmbaruesit privat Isa Gacaferi me të cilin është përfunduar procedura përmbarimore sipas urdhërit përmbarimor P.nr.2837/19 të datës 11.12.2019.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 42 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) i cili përcakton se “*Propozimi për përmbarim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore pa pëlqimin e debitorit*” dhe par. 2 të po këtij neni i cili përcakton se “*Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbarim organi përmbarues e përfundon përmbarimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht*“, dhe duke u bazuar në njoftimin e Përmbaruesit Privat, se debitori ka përmbyllur obligimin ndaj kreditorit, këtë çështje përmbarimore e përfundoi në tërësi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 42 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2383/22, datë 24.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.